



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 4

Rrogozhinë, më 08.08.2023 ora 15 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.2781.Prot datë 07.08.2023 (njoftimi Këshilltarëve i është bërë elektronikisht ditën e Shtunë, datë 05.08.2023) si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 31.07.2023.
- 3- Ceremonia e marrjes-dorëzimit të detyrës së Kryetarit të Bashkisë.
 - a. Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë.
 - b. Kryerja e betimit të Kryetarit të Bashkisë.
- 4- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Lije Dedej, Saimir Cani, Besnike Coraj, Sokol Gosa, Fatbardha Sina, Altin Tosku, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Alime Hoxha, Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Ferdi Avdiu, Mitat Daja, Bajazit Thaçi.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.



2. Etjen Xhafaj - Deputet i Partisë Socialiste në Parlamentin e Shqipërisë për Kavajën dhe Rrogozhinën e Qarkun e Tiranës.
3. Afrim Qëndro - Prefekt i Qarkut Tiranë.
4. Të gjithë qytetarët me njoftim publik në stendën e Bashkisë dhe në faqen zyrtare të këshillit bashkiak në rrjetin social facebook.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, deputeti i zonës, Prefekti i Qarkut, përfaqësues i Këshillit të Qarkut (Sekretari i Këshillit të Qarkut), qytetarë të ndryshëm.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 18 Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përsëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm ku marrin pjesë në sallë 18 (tetëmbëdhjetë) Këshilltarë, mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Ju kemi thirrur në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak sipas dispozitave që na ngarkon ligji për ceremoninë e betimit të Kryetarit të ri të Bashkisë, të dalë nga zgjedhjet vendore të zhvilluara në datën 23 Korrik në Bashkinë Rrogozhinë.

Para se të kalojmë në hapat proceduralë të mbledhjes, falenderoj për pjesëmarrjen të ftuarit tanë z. Etjen Xhafaj deputet i Partisë Socialiste në Parlamentin e Shqipërisë për Kavajën dhe Rrogozhinën e Qarkun e Tiranës, z. Afrim Qëndro Prefekt i Qarkut Tiranë, si dhe të gjithë qytetarët e pranishëm, që ndodhen në këtë sallë.

Në mbledhjen e datës 31.07.2023 nga Këshilli u morën tre vendime që i janë përcjellë për “Verifikim Ligjor” Prefektit të Qarkut të cilët janë:

Vendim nr . 11 . Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhië znj. Lije Dedej.

Vendim nr . 12 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr . 13 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i pushtetit vendor.



Këto vendime sipas komunikimit me Prefektin janë gjetur në përputhje me ligjin dhe shkresa drejt Bashkisë është dërguar dje me postë dhe pritjet të mbërrijë tek ne ditën e nesërme.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

Miratim i rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës të nderuar Këshilltarë? E hedhim në votim. Pro, Kundër, Abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 18-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 31.07.2023. Ky material ju është dërguar elektronikisht. Jeni dakord të nderuar Këshilltarë? E hedhim në votim. Pro, Kundër, Abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 18-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Bazuar në Nenin 60 pika 1 dhe 3, të Ligjit 139 “Për vetëqeverisjen vendore”, pasi mandati i Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Rrogozhinë është vërtetuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Durrës, në cilësinë e Kryetares së Këshillit Bashkiak, shpall vlefshmërinë e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë.

-Duartrokitje në sallë nga të gjithë të pranishmit.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Kalojmë në procedurën e betimit të kryetarit. Po lexoj formulën e betimit sipas ligjit,

“Betohe në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e Kryetarit të Bashkisë dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Rrogozhinë, dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Edison Memolla . Betohe.

-Duartrokitje në sallë nga të gjithë të pranishmit.

Mukades Gixhari . Ftoj Prefektin e Qarkut z. Afrim Qëndro për t’i vendosur shiritin Kryetarit të Bashkisë.



-Duartrokitje në sallë nga të gjithë të pranishmit, pas vendosjes së shiritit.

Mukades Gixhari . Atëherë ftoj kryetarin e Bashkisë sipas rregullores të mbajë fjalën e rastit.

Edison Memolla . Faleminderit të gjithëve! Faleminderit këshilltarëve, faleminderit pjesëmarrës. Faktikisht kjo ka qenë një fushatë e gjatë që ka zgjatur përtej çdo lloj mendimi, unë ju falemderoj të gjithëve të majtë e të djathtë pavarësisht se çfarë kanë votuar apo si kanë votuar, unë do jem kryetar i të gjithëve që nga nesër që marr zyrarisht punën. Do jem gjithmonë me ju në bashkëpunim me këshillin bashkiak do të ecim bashkë dhe do të bëjmë për të mirën e qytetit. Kështu që ... është shumë e rëndësishme që të kemi bashkëpunimin e të gjithëve edhe të bëjmë një gjë të mirë që këto 4 vite të jenë një gjë e mirë për të gjithë komunitetin për gjithë zonën për gjithë njësitë administrative dhe ta kthejmë Rrogozhinën një atraksion turistik sepse kemi një bregdet të mrekullueshëm. Kështu që shumë faleminderit dhe na presin shumë punë të mira përpara. Ju faleminderit.

-Duartrokitje në sallë nga të gjithë të pranishmit.

Mukades Gixhari . Mund të firmosësh betimin.

-Kryetari i Bashkisë z. Edison Selman Memolla nënshkruan formulën e betimit sipas ligjit.

Vendim nr. 14 . Miratohet shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Edison Selman Memolla, si kandidat i shpallur fitues në zgjedhjet vendore të datës 23.07.2023 me vendimin nr.718 datë 01.08.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe sipas vërtetimit të mandatit me vendimin nr.11-2032-4545/153 datë 07.08.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Mukades Gixhari . Suksese! Tani ja japim fjalën të ftuarve z. Etjen Xhafaj. Një fjalë përshëndetëse.

Etjen Xhafaj . Nuk dua të zgjatem shumë, besoj që Edisoni në pjesën e vet e përmbloodhi atë që është detyra e çdo të zgjedhuri publik pavarësisht biletës me të cilën ai vjen në postet apo në karriket në të cilën e ushtron postin e vet është të shërbejë. Të ju shërbejë jo vetëm qytetarëve që e kanë votuar apo e kanë zgjedhur por dhe atyre që kanë votuar kundër dhe atyre që nuk kanë votuar fare dhe atyre që nuk kanë arritur akoma moshën e votimit. Dhe është shumë e rëndësishme besoj që për qytete të vogla, ky komunitet që është i ulur në këtë tryezë dhe këta njerëz që janë këtu rrotull dhe ata njerëz që janë aty jashtë si në Lekaj ashtu dhe në Kryevidh si



në Sinaballaj, Gosë dhe këtu në Rrogozhinë në qytet të punojnë të gjithë së bashku për të sjellë një të ardhme më të mirë për fëmijët e të gjithëve së bashku sepse në fund të ditës aksionerët e vërtetë të asaj që është thelbi zemra e një qyteti janë të gjithë qytetarët e atij qyteti. I uroj Edisonit një mandat të mbarë në të cilin të bëjmë sa më shumë punë së bashku dhe të gjithë së bashku këtu edhe me Këshillin Bashkiak dhe me qytetarët se në fund të ditës kjo është detyra jonë ky është misioni jonë publik. Shumë faleminderit të gjithëve dhe punë të mbarë për këto 4 vjet.

Mukades Gixhari . Faleminderit të gjithëve dhe i urojmë suksese në vazhdim kryetarit të Bashkisë z. Edison Memolla!

-Duartrokitje në sallë nga të gjithë të pranishmit.

Mukades Gixhari . Atëherë kalojmë tek pika 4 e rendit të ditës. Përpara keni të fotokopjuara dy projektvendime për dhënien e ndihmave ekonomike qytetarëve. Jeni dakord të nderuar këshilltarë që t’i marrim në shqyrtim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 18-vota pro marrja në shqyrtim e dy projektvendimeve: “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Dhe “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në Miratimin e projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- Miratohet me 18-vota pro, projektvendimi, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”.

Vendim nr.15. Miratohet me 18-vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2797.Prot datë 08.08.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek pika tjetër Miratim i projektvendimit,“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.



- *Miratohet me 18-vota pro, projektvendimi, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.*

Vendim nr.16. Miratohet me 18-vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2777.Prot datë 07.08.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.

Mukades Gixhari . Tani Prefekti një fjalë përshëndetëse.

Afrim Qëndro . Mirë, kryetare për procedurë herë tjetër nuk duhet të marrësh vendime kur është Prefekti dhe deputeti në sallë sepse ne nuk kemi të drejtë të jemi prezentë. Ne jemi sot për konstituimin e Kryetarit. Unë dua t’i falenderoj të gjithë qytetarët e Rrogozhinës dmth të djathtë dhe të majtë edhe ato që nuk kanë votuar sepse realisht ka qenë një fushatë shumë e gjatë e përsëritur dhe i kemi detyruar që të rrinë nën atë trysinë që sjellin me të vërtetë votimet. Më në fund unë e kam thënë edhe në mbledhjen e këshillit sovrani ka vendosur më në fund që Edisoni të jetë kryetari i Bashkisë për mandatin e ardhshëm për 4-vitet e ardhshme. Gjithashtu sovrani ka vendosur që këshilli bashkiak të mos jetë më si ai i mëprashmi por të jetë një këshill bashkiak që përfaqëson më së miri të gjithë shtresat e shoqërisë dhe të gjithë partitë politike të majta të djathta të qendrës në dashtë doni t’i quajmë disa përfaqësues që janë këtu por dhe përfaqësues të tjerë të cilët kanë marrë vota si persona dhe si njerëz me kontribut në komunitet. Kështu që unë besoj që ky këshill bashkiak do ta ketë cilësinë dhe vendimmarrjen më të mirë se këshilli i parë sepse duhet të dëgjojë zërin e opozitës dhe Edisoni duhet ta dëgjojë me vëmendje zërin e opozitës në këtë këshill bashkiak dhe të gjithë bashkë në fund të ditës Rrogozhina nuk është një qytet aq i madh bashkë me rrethinat përreth është një qytet që ju jetoni këtu bashkë keni krushqi me njëri tjetrin. Dhe unë do t’i uroja kryetarit të bashkisë që ta dëgjojme me vëmendje të bëjë punë të mira për qytetin t’u shërbejë njerëzve në fund të ditës është kryeshërbëtori i Rrogozhinës. Nuk është ai kryetari i bashkisë që shumë njerëz kanë në mend por është njeriu që punon shumë dhe fle më pak se të gjithë tjerët dhe natyrisht punë të mira shëndet për të gjithë dhe shumë faleminderit për ceremoninë sot.

-Duartrokitje në sallë nga të gjithë të pranishmit.

Gëzim Demiraj (Përfaqësues i këshillit të qarkut Tiranë, sekretari i këshillit) . Në emër të Këshillit të Qarkut Tiranë i uroj Edisonit suksese në detyrën si qytetari numër një i qytetit të Rrogozhinës. Ne shprehim bindjen si këshill qarku që Edisoni do të jetë në nivele për të bërë një transformim rrënjësor të udhëzimit të pushtetit lokal të bashkisë së Rrogozhinës. Suksese dhe këshillit bashkiak suksese dhe bashkëpunim të mëtejshëm me Edisonin.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Mukades Gixhari . Ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen për vëmendjen! Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit.

-Duartrokitje në sallë nga të gjithë të pranishmit.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 15^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 11 min ; 58 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 7 (shtatë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

**Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**